



PROCESVERBALI PËR DËGJIMIN PUBLIK TË KAB NË FSHATIN KËRPIMEH

Dëgjimin publik e hapi drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, dukë përshëndetur dhe falenderuar të gjithë të pranishmit për kohën që kanë ndarë të jenë prezant dhe të kontribuojnë me propozimet e tyre.

Drejtori Osmani tha se jemi në fazën e hartimit e kornizën Buxhetore, ku në këtë kornizë do të planifikohen projektet prioritare për vitin 2023-2025. Ideja e këtyre takimeve është që të marrim propozimet, kërkesat e komunitetit të juaj, ku kemi filluar me Kërpimehun, pastaj me vazhdojmë me Lluzhanin, Orllanin si dhe dy dëgjime tjera në komunën e Podujevës.

Komuna e Podujevës për vitin bazë të Qarkores Buxhetore që ka ardh nga Ministria e Financave për vitin buxhetor 2023 do të ketë një buxhet mbi 27 milionë euro, që është një lajm i mirë që kemi një rritje rreth 4 milionë euro. Për këtë periudhë nuk janë të definuara saktë limitet buxhetore në kategorinë e mallrave, të pagave të komunalive, subvencioneve dhe të kategorinë kapitale mirëpo gjatë hartimit të kornizën afatmesme buxhetore ndër të tjera ka edhe një arsyе pse bëhet KAB, sepse është edhe një kërkesë ndaj Ministrisë së Financave për limitet buxhetore të cilat do ti kemi, dmth në bazë të nevojave dhe prioriteteve tona ndërtojmë këtë koncept dokumentë.

Me këtë rritje do të përfshijmë të gjitha kategoritë buxhetore, ku në bazë të një parashikimi për investimet kapitale do të ketë një rritje prej mbi 2 mil euro, në kategorinë e subvencioneve do të ketë rritje të ndjeshme ku nga 900 mijë do të rritet në 1 mil e 600 mijë, në kategorinë e mallrave gjithashtu do të ketë një rritje.

Sipas kësaj kornize parashohim investime në cdo fshat, në cdo lokalitet, dmth një shpërndarje të arsyshme duke u bazuar në prioritete, i kemi prioritiziuar sektorin e Shëndetësisë dhe Arsimit, kunë Arsimit kemi pothuajse 15 fish buxhet më shumë, ndërsa tek Shëndetësia do të kemi projekte madhore si ndërtimi i Urgjencës.

Tani pa dashtë me ju marr kohë më shumë kasha dashtë me hap debatin dhe me i dëgju kërkesat dhe prioritetet e juaja, tha drejtori Osmani.

Përfaqësuesi i fshatit Pakashticë e Poshtme; "ne i kemi paraqit prioritetet tona vitin e kaluar por asnjë deri tani nuk është realizuar, kemi kërkuar që rruga e cila hyn në fshat të vazhdohet për shkak që ato punime kanë mbet në gjysmë tash e sa kohë për shkak të buxhetit, pastaj ndërtimin e trotuarit për shkak të nxënësëve, ndriqimi është tjetër kërkesë e jona e cila poashtu s'është realizuar", tha përfaqësuesi Kajtazi.

Selman Hoti- Kërkon të realizohen projektet e përfaqësuesit Kajtazit të realizohen gjatë vitit 2022, ndërsa për priorititet e vitin 2023-2025 thotë do t'i parashtoj më vonë.

Pyet gjithashtu cka kanë në planë komuna e Podujevës, për ngritjen e Arsimit në shkolla ?

Drejtori Osmani i jep disa sqarime profesorit Hoti, në lidhje më kërkesën e tij, i cili potencon që shumë projekte janë në fazën e prokurimit ndërsa në pjesën e dytë të vitit pritet të realizohen shumë projekte, dmth rezultatet e investimeve kapitale ende janë në fazën fillestare për implementim.

Ndërsa për investimet për Arsim, ne parashohim 1 mil e 600 mijë, deri në vitin 2023 secila shkollë do të ketë kabinetet e veta, biologji, kimi, Tik, si dhe digitalizimi i shkollave si platforma më e mirë për mësim online, një platformë mjaftë moderne si dhe projekt tjetër do të jetë tabela digitale në 2023-2024 në cdo klasë do të ketë tabela digitale.

Qefser Behrami- drejtor i shkollës "Hamit Selimi" në Kërpme, unë nuk do të flas për kërkesat e kësaj zone, une do të flas për një prioritet tjetër, e kemi shkollën e vjetër e cila është më e fortë sesa e reja, unë propozoj që ajo shkollë të rinovalohet dhe të ndërtohet qerdhe, sepse këtu kemi 7 fshatra të cilët mund t'i dërgojnë fëmijet në këtë qerdhe.

Banore e fshatit Kërpimeh; "Lumi rrjedhës në shtëpinë tonë dhe rrreth 5 shtëpi tjera, na shkakton shumë dëme në stinën e pranverës dhe të vjeshtës, kërkesa jonë është prej 2006, pos dëmëve ajo j aka marr jetën edhe vllaut tem. Kërkesë tejet e nevojshme të cilën me shpenzime tona nuk mund ta mbulojmë".

Muhamed Kameri - Përfaqësues i fshatit Metehi "Kërkesat tona të vitit të kaluar, dua të di a janë përfshirë në buxhet të vitit 2022" ?

Jusuf Gashi – përfaqësues i fshatit Dobërdol, " në vitin e kaluar ne kemi paraqitur kërkesat tona për këtë vit, unë kam bërë një list të cilat janë intervenime të nevojshme, qofshin për rrugë, ndriqim apo ndonjë rruge lidhëse me fshatrat tjera".

Përfaqësues i fshatit Brecë – Isuf Jashari "I kam dy dy kërkesa për rrugë në fshatin Brecë, njëra rrugë është shtruar në zhavor ndërsa i mungojnë mbrojtëset, ndërsa rruga tjetër rrugë e vdekjes për shkak të përfaqësues i fshatit Revuqi – " E kemi një rrugë të paafaltuar, për shkak të një banori i cili nuk po e lëshon rrugën, kemi lumen llap i cili rrezikon një mur në fshatin tonë, pastaj kemi kanalizimet pa kapak, shkaktojnë rrezik për banorët".

Një përfaqësues i fshatit Pakashticë - Jashar Babatinca " Kërkesa jonë është mburoja e lumit, sepse rrezikon lagjen dhe shtëpitë tona, ndërsa kërkesa tjetër e dytë është që ne nuk kemi kanalizim".

Përfaqësues i fshatit Tërrnovicë –Halit Mehana, "Në fshatin tonë pothuajse të gjithë familjet janë shpërngul për shkak të kushteve elementare, rruga jonë është shumë e nevojshme të rregullohet sepse ka shume banorë që janë të interesuar të punojnë tokën në fshat edhe pse janë të shpërngulur në vende tjera".

Përfaqësues i fshatit Pollatë – Fadil Ademi, “Edhe ne si të tjerët kemi kërkesat tonë fshatit, meqë pozita gjeografike e fshatit është afër lomit ne kemi nevojë për dy ura, njëra është lidhja e fshatit Pollatë me fshatin Potakë, ndërsa tjetra është në lagjen Latifi dhe tek Mulliri”, kemi mungesë të ndriqimit”.

Një banor i fshatit Kërpimh i drejtohet drejtorit të Shëndetsisë me pyetje, “Pse mungon laboranti në Kërpimeh dhe pyetja e dytë është a do të realizohet parku i premtuar në fshatin tonë” ?

Përparim Kadriu – Banor i fshatit Revuq, “Shumë rrugë janë përmendur edhe vitin e kaluar në diskutim publik, dua të di saktësisht a janë rrugët me prioritet me të madh apo ndonjë rrugë tjetër, dua të potencojo se rruga më me prioritet është rruga e Mirofçëve, pastaj rruga tjetër është e Bekteshëve, aty kanë familjar të sëmur dhe gjatë stinës së dimrit e kanë shumë problem me i dërgu në shërbime mjekësore, pastaj ne kemi mungesë të trotuareve”.

Besmir Sahiri – përfaqësues i lagjes së Xhakalive, “Kam dy pyetje, në lidhje më rrugën “Avdyl Januzi” është e shtruar para 7-8 viteve, dhe është shumë e dëmtuar, ajo lagje është në gjendje të keqe, kanë kaluar ujërat e zeza, dhe projekt i tjetër është rruga te lagjia ime, që është vetëm e shtruar me zhavor na është premtu në fushat, a do të realizohet ky projekt”.

Një banor tjetër kërkesë për largimin e mbeturinave në fshatin Kërpimeh.

Drejtori i Shkollës së Metehisë – Qefser Behrami, “Potencon problemin me ujin në shkollë për shkak që pusi i hapur nga organizata e Katarit nuk i ploteson kriteret për pije”.

Një banor i fshatit Metehi potenconon problemin e pendave të bllokuara në Metehi.

Përfaqësuesi i fshatit Dobërdol, potencon mungesën e ndriqimit brenda fshatit, ndërsa mirëmbajtësi i shkollës së Kërpimehut thekson problemin e Kalldajit, i cili është i vogël dhe nuk i plotëson nevojat e nxënësëve për një ambient të ngrohtë mësimor.

Drejtori Osmani thekson se shumicën e këtyre kërkesave janë të adresuara edhe me shkrim ku premton trajtimin e këtyre kërkesave në menyrë që brenda këtyre viteve të realizohen këto projekte që të plotësohen nevojat e banorëve.

Dëgjimi publik është i transmetuar online edhe në ueb faqen zyrtare si dhe në rrjetin social facebook, ku në vegëzën e mëposhtme gjeni dëgjimin publik të KAB në fshatin Kërpimeh me rrethin.

<https://www.facebook.com/KomunaEPodujeves/videos/5146317088794708>

01.06.2022

Podujevë

f



LIVE

LAPIO





TV Llapi

TVL

ALB

TV Llapi

Komuna e Podujevës - Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore

1:13:09



V Llapi

Komuna e Podujevës - Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore



IVE

PROUDLY PRESENTS


FALEMINDERIT

DITËN E MIRË,



TV Llapi

Komuna e Podujevës - Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore



Llapi

Komuna e Podujevës - Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore